



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

SHPALLJE PËR VENDE VAKANTE  
NË POZICIONIN “OFICER SIGURIE”

Në zbatim të Ligjit Nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 600, datë 9.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për Oficerët e Sigurisë në Shkollat Publike”, si dhe në urdhrin Nr. 531, datë 14.09.2018 të MASR “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall procedurat **për 61 vende vakante** për oficerë sigurie në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të mëposhtme:

Nr.	IAVPAPU	NUMRI I VENDEVE TË LIRA
1.	ELBASAN	7
2.	DURRËS	9
3.	SHKODËR	2
4.	BERAT	3
5.	KAVAJË	4
6.	LEZHË	1
7.	KURBIN	3
8.	LIBRAZHD	2
9.	POGRADEC	2
10.	VLORË	3
11.	DIBËR	2
12.	BULQIZË	2
13.	GJIROKASTËR	2
14.	KUÇOVË	2
15.	MALËSI E MADHE	2
16.	MALLAKASTËR	2
17.	PEQIN	1
18.	PUKË	2
19.	SKRAPAR	2
20.	DELVINË	1
21.	FIER	1
22.	GRAMSH	1

23.	HAS	1
24.	KOLONJË	1
25.	MIRDITË	1
26.	SARANDË	1
27.	TEPELENË	1
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>61</b>

## 1 Përshkrim i përgjithshëm i vendit vakant

Siguria në shkollë është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda edhe jashtë mjediseve të shkollës. Lufta kundër dukurive të tilla si: episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkolla etj., janë prioritet i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe i Ministrisë së Brendshme.

Menaxhimi i sigurisë në shkolla kërkon një ndërveprim të vazhdueshëm me nxënësit dhe stafin e shkollës, gjë të cilën merr përsipër të realizojë oficeri i policisë në shkolla. Për këtë arsye, duke synuar rritjen e sigurisë nëpërmjet ndërveprimit dhe parandalimit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme nëpërmjet marrëveshjes së firmosur midis palëve, kërkon të krijojë një qasje të re nëpërmjet krijimit të rolit të Oficerit të Sigurisë në shkollë. Ky pozicion i ri pune në shkollë, merr rol të rëndësishëm për krijimin e një mjedisi të sigurt, përmes ndërtimit të marrëdhënieve të forta e të qëndrueshme me nxënësit, stafin e shkollës, prindërit dhe komunitetin.

## 2 Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Monitoron mjedisin e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rreth të situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo cenimit të pronës së shkollës.
- Ofron një prani të dukshme dhe të aksesueshme brenda shkollave dhe më gjerë në komunitet.
- Punon me shkollat për përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për problematika si: përdorimi i drogës, bullizmi, siguria në internet, pasoja e dhunës dhe krimit;
- Parandalon dhe menaxhon rastet emergjente dhe të dhunës në shkollë.
- Kontribuon në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, ligjin dhe drejtësinë.
- Merr pjesë në takimet me prindër dhe në takime periodike të stafit pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë, sa herë kërkohet nga drejtori i shkollës.
- Bashkëpunon me drejtorinë e shkollës dhe stafin pedagogjik, për të garantuar dhe krijuar një mjedis të sigurt në shkollë.

- Ndërvepron me drejtorinë e shkollës dhe me stafin e saj duke ndërhyrë dhe parandaluar në rastet e thyerjes së disiplinës, menaxhimit të krizave dhe në rastet e emergjencave.
- Krijon një plan sigurie të shkollës, duke përcaktuar risqet e mundshme, daljet emergjente dhe duke minimizuar burimet e aksidenteve.
- Bashkëpunon me agjencitë ligjzbatuese dhe shërben si ndërlidhës mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit, me qëllim parandalimin e veprave kriminale.
- Evidenton situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike, brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës, dhe njofton oficerin e policimit në komunitet.
- Shërben si oficer raportues dhe menaxhues, i situatave, të cilat mund të paraqesin një rrezikshmëri në mjediset e shkollës.
- Bashkëpunon dhe ndërmjetëson me punonjësin e shërbimit psikosocial në situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës.
- Ofron prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.
- Përshtatet me komunitetin e zonës në të cilën ndodhet shkolla ku do të ushtrojë veprimtarinë ku do të veprojë.
- Realizon takime informuese me nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit, për rastet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, me qëllim që të rris ndërgjegjësimin qytetar.
- Harton raporte javore, vjetore dhe të situatës/incidentit të cilat do t'ia dërgojë Zyrës për Koordinimin dhe Monitorimin.
- Raporton në mënyrë periodike pranë autoriteteve përgjegjëse (Njësi Arsimore Vendore, Zyrë së Koordinimit dhe Monitorimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë), sipas formateve të miratuara të raportimit.
- Zbaton parimet etike për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve të veçanta dhe sensitive.
- Zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, vetëm në raste emergjente ose me vendim nga drejtoria e shkollave.

### **3 Kriteret e pranimit**

#### **3.1 Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepër penale;
- f) Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.

### 3.2 Kritere të veçanta

Kandidati duhet të plotësoj kriteret e mëposhtme:

- a) Të ketë diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë, drejtësisë;
- b) Të jetë jo më shumë se 40 vjeç;
- c) Të ketë njohuri të mira kompjuterike.

### 4 Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

- a) Jetëshkrim i plotësuar (CV-Curriculum Vitae) në përputhje me formatin Europass (adresa e e-mailit është e detyrueshme);
- b) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës/Certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse (*i detyrueshëm*);
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID) (*i detyrueshëm*);
- e) Vërtetim mjeko-ligjor (*i detyrueshëm*);
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore (*i detyrueshëm*);
- g) Vërtetim i lëshuar nga gjykata (*i detyrueshëm*);
- h) Vërtetim i lëshuar nga prokuroria (*i detyrueshëm*);
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- j) Vlerësime dhe rekomandime nga punëmarrësi i mëparshëm (nëse ka).
- k) Kërkesë me shkrim ku përcakton drejtorinë arsimore/zyrën arsimore, ku dëshiron të shërbejë (*i detyrueshëm*).
- l) Deklaratë nga kandidati me anë e së cilës autorizon MASR dhe MB (Ministrinë e Brendshme) të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 2 bashkëngjitur.

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet brenda datës **01.03. 2019** në një nga këto mënyra:

- a) Onlain (online) në adresën elektronike [oficere-sigurie@arsimi.gov.al](mailto:oficere-sigurie@arsimi.gov.al);
- b) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- c) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

## 5 Fazat e konkurrimit

### 5.1 Verifikimi paraprak i dokumentacionit do të kryhet nga MASR nga data 04. 03. 2019 deri më datë 06. 03. 2019.

- Në fazën e verifikimit paraprak do të kryhet kontrolli i dokumentacionit të kërkuar në pikë 4 të kësaj shpallje.
- Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazat e mëtejshme të konkurrimit do të shpallet në ueb-in e MASR brenda datës **07.03.2019**.
- Kandidatët e skualifikuar, do të njoftohen me postë elektronike brenda datës **07. 03. 2019**.
- MASR pas njoftimit të kandidatëve do të pranojë ankimimet në datat **11 – 13. 03. 2019**.
- Në përfundim të shqyrtimit të ankimimeve, shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar, të cilët do të paraqiten për intervistim, do të bëhet brenda datës **15. 03. 2019** në ueb-in (web) zyrtar të MASR-së.
- Procedura e ankimimit do të bëhet në një nga këto mënyra:
  - a) Onlain (online) në adresën elektronike [oficere-sigurie@arsimi.gov.al](mailto:oficere-sigurie@arsimi.gov.al);
  - b) Me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - c) Dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

### 5.2 Intervista gjysmë e strukturuar<sup>1</sup> (sipas formatit të shtojcës 3) do të zhvillohet në datat 18.03.2019- 20.03.2019.

#### **Komisioni i intervistimit do të ketë 5 anëtarë me këtë përbërje:**

- Dy nga MASR (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë)
- Dy nga MB (Ministria e Brendshme)
- Një nga Urdhri i Psikologut.

#### **a) Intervista do të kryhet rreth legjislacionit të mëposhtëm:**

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

- Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Manuali për Policimin në Komunitet;
- Broshurat informuese (për mësues, prindër dhe nxënës) rreth rolit të Oficerit të Sigurisë në Shkolla.
- Kodi i Etikës i Mësuesve në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat.

#### **b) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;

---

<sup>1</sup> Intervista gjysmë e strukturuar është ndërtuar nga një grup pyetjesh paraprake, por që është e hapur, duke lejuar që ide të reja të ngrihen gjatë intervistës si rezultat i asaj që intervistuesi thotë.

- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **6. Shpallja e rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit.**

- Në përfundim të intervistës, Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda datës **22. 03. 2019** do të publikojnë në faqen e saj zyrtare, listën e kandidatëve që kanë kaluar me sukses intervistën dhe që do të trajnohen për “Oficerë sigurie” në Akademinë e Sigurisë.
- Në përfundim të intervistët kandidatët do të njoftohen individualisht në adresën elektronike për pikët e fituara gjatë intervistës.
- Lista e kandidatëve të kualifikuar i përcillet Akademisë së Sigurisë brenda datës **26. 03. 2019**, për të vijuar me trajnimin mbi sigurinë në shkolla dhe certifikimin e tyre në përfundim të trajnimit.
- Akademia e Sigurisë njofton kandidatët për “Oficerë sigurie”, për datën e fillimit të trajnimit.
- Akademia e Sigurisë, në përfundim të trajnimit realizon testimin e kandidatëve të trajnuar dhe bënë certifikimin e tyre. Lista e kandidatëve që përfundojnë me sukses këtë testim i përcillet zyrtarisht MASR.

**Shtojca 1. Institucionet arsimore, që do të kenë oficerë sigurie**

<b>Nr.</b>	<b>Institucioni arsimor</b>	<b>DAR/ZA</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Nr.nx</b>
1	“Ismail Qemali”	Tiranë qytet	Tiranë	1720
2	“B.Dudë Karbunara”	Berat	Berat	790
3	“Kristaq Capo”	Berat	Berat	409
4	“Muhamer Janina”	Berat	Ure Vajgurore	431
5	Kutalli	Berat	Ure Vajgurore	312
6	Syzes	Berat	Ure Vajgurore	167
7	Bulqizë	Bulqizë	Bulqizë	510
8	“Rifat Manjani”	Bulqizë	Bulqizë	308
9	"Sulejman Delvina"	Delvinë	Delvinë	252
10	“Fuat Babani”	Devoll	Devoll	501
11	“Said Najdeni”	Dibër	Dibër	1051
12	Maqellarë	Dibër	Dibër	380
13	Kastriot	Dibër	Dibër	214
14	“Leonik Tomeo”	Durrës	Durrës	980
15	“Naim Frashëri”	Durrës	Durrës	804
16	“Gjergj Kastrioti”	Durrës	Durrës	587
17	“Olsi Lasko”	Durrës	Durrës	437
18	“Bernardina Qeraxhia”	Durrës	Durrës	416
19	Kullë	Durrës	Durrës	262
20	Manëz	Durrës	Durrës	255
21	Sukth i Ri	Durrës	Durrës	221
22	Katundi Ri	Durrës	Durrës	214
23	“Dom Nikoll Kacorri”	Durrës	Durrës	188
24	“Besnik Hidri”	Durrës	Durrës	163
25	16 Shtatori	Durrës	Shijak	362
26	“Sami Frashëri”	Elbasan	Belsh	374
27	“Tomorr Sinani”	Elbasan	Cërrik	294
28	“Osman Gjini”	Elbasan	Cërrik	258
29	“Miranda Baku”	Elbasan	Cërrik	204
30	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	Elbasan	725
31	“Dhaskal Todri”	Elbasan	Elbasan	683
32	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	Elbasan	668
33	“Ahmet Dakli”	Elbasan	Elbasan	429
34	“Vasil Kamami”	Elbasan	Elbasan	402
35	“Mahmut & Ali Cungu”	Elbasan	Elbasan	313
36	“Luigj Gurakuqi”	Elbasan	Elbasan	295
37	“Anastas Çakalli”	Elbasan	Elbasan	202
38	“Mahir Domi”	Elbasan	Elbasan	200
39	“Janaq Kilica”	Fier	Fier	1127
40	“Perikli Ikonomi”	Fier	Fier	437
41	“Mustafa Hoxha”	Fier	Fier	323
42	“Jovan Ndreko”	Fier	Fier	168

43	“Zhani Ciko”	Fier	Patos	373
44	“Adem Vrapi”	Fier	Roskovec	510
45	“Siri Shaplllo”	Gjirokastrë	Gjirokastrë	369
46	“Asim Zeneli”	Gjirokastrë	Gjirokastrë	298
47	“Shefqet Guzi”	Gramsh	Gramsh	493
48	“Skenderbeu”	Has	Has	624
49	“Ibrahim Rugova”	Kamëz	Kamëz	1477
50	“Elez Isuf Ndreu”	Kamëz	Kamëz	752
51	“Gramoz Palushi”, Paskuqan	Kamëz	Kamëz	666
52	“Isa Boletin”, Paskuqan	Kamëz	Kamëz	503
53	“Sulejman Elezi”	Kamëz	Kamëz	204
54	“Mustafa K. Atatürk”	Kamëz	Tiranë	151
55	“Aleksandër Moisiu”	Kavajë	Kavajë	746
56	Luz i Vogël	Kavajë	Kavajë	174
57	Haxhi Qehaj	Kavajë	Rrogozhinë	327
58	Gosë	Kavajë	Rrogozhinë	207
59	Petro Nini Luarasi	Kolonjë	Kolonjë	225
60	“Raqi Qirinxhi”	Korçë	Korçë	491
61	“Themistokli Gërmenji”	Korçë	Korçë	489
62	“Ymer Dishnica”	Korçë	Korçë	226
63	“Faik Konica”	Korçë	Korçë	197
64	Maliq	Korçë	Maliq	268
65	Pirg	Korçë	Maliq	222
66	Pojan	Korçë	Maliq	149
67	“Shote Galica”	Krujë	Krujë	1134
68	Skënderbeu Krujë	Krujë	Krujë	455
69	Bubq	Krujë	Krujë	150
70	“5 Tetori”	Kuçovë	Kuçovë	441
71	“Myrteza Kepi”	Kuçovë	Kuçovë	242
72	“Havzi Nela”	Kukës	Kukës	1207
73	“Bajram Abdiu”	Kukës	Kukës	255
74	“At'shtjefën Gjeçovi”	Kurbin	Kurbin	833
75	“Arif Halil Sulaj”	Kurbin	Kurbin	547
76	Milot	Kurbin	Kurbin	231
77	“At' Shtjefën Kurti”	Kurbin	Kurbin	210
78	“Hydajet Lezha”	Lezhë	Lezhë	885
79	“Llesh Nik Daka”	Lezhë	Lezhë	200
80	“Karl Gega”	Lezhë	Lezhë	167
81	Zejmen	Lezhë	Lezhë	150
82	“Ibrahim Muça”	Librazhd	Librazhd	582
83	“Halit Berzeshta”	Librazhd	Prrenjas	377
84	“Sali Halili”	Librazhd	Prrenjas	235
85	“Dilaver Nezha”	Librazhd	Prrenjas	162
86	“Miti Zoi Zaka”	Lushnje	Divjake	366
87	“18 Tetori”	Lushnje	Lushnje	677



88	“Jani Nushi”	Lushnje	Lushnje	255
89	“Vath Korreshi”	Lushnje	Lushnje	197
90	Fier Shegan	Lushnje	Lushnje	157
91	“Sherif Hoxha”	Malësi E Madhe	Malësi E Madhe	368
92	“Dodë Kaçaj”	Malësi E Madhe	Malësi E Madhe	161
93	“Dervish Hekali”	Mallakastër	Mallakastër	483
94	“Hajredin Fratari”	Mallakastër	Mallakastër	193
95	“Shaban Çollaku”	Mat	Klos	358
96	“Pjetër Budi”	Mat	Mat	466
97	“28 Nëntori”	Mat	Mat	381
98	Rrëshen	Mirditë	Mirditë	373
99	“Mustafa Kemal Atatürk”	Peqin	Peqin	361
100	“Zihni Magani”	Peqin	Peqin	306
101	“Sami Frashëri”	Përmet	Përmet	312
102	“Muharrem Çollaku”	Pogradec	Pogradec	614
103	“Gjergj Pekmezi”	Pogradec	Pogradec	563
104	“Qemal Bazelli”	Pogradec	Pogradec	226
105	“14 Engjëjt”	Pogradec	Pogradec	201
106	Fushë-Arrëz	Pukë	Fushë-arrëz	196
107	Sabah Sinani	Pukë	Pukë	209
108	“Hasan Tahsini”	Sarandë	Sarandë	620
109	“Jordan Misja”	Shkodër	Shkodër	670
110	“28 Nëntori”	Shkodër	Shkodër	584
111	“Oso Kuka”	Shkodër	Shkodër	543
112	“Shejnaze Juka”	Shkodër	Shkodër	451
113	“Adem Haxhija”	Shkodër	Shkodër	241
114	“Nikollë Zogoriani”	Shkodër	Shkodër	157
115	“Nënë Tereza”	Shkodër	Vau Dejes	254
116	“Muhamet Kondi”	Skrapar	Poličan	150
117	“Ramiz Aranitasi”	Skrapar	Skrapar	330
118	“Abaz Shehu”	Tepelenë	Tepelenë	257
119	“Ibrahim Hasmema”	Tiranë	Tiranë	260
120	“Sadik Stvileci”	Tiranë	Tiranë	254
121	“Myslym Shima”	Tiranë	Tiranë	253
122	“Sadi Nuri”	Tiranë	Tiranë	238
123	Farkë	Tiranë	Tiranë	231
124	Vaqarr	Tiranë	Tiranë	178
125	Kashar Qender	Tiranë	Tiranë	144
126	Baldushk	Tiranë	Tiranë	143
127	“Bahri Nela”	Tiranë	Tiranë	143
128	“Isa Adem Boletini”	Tiranë	Vorë	610
129	“Vajdin Lame”	Tiranë	Vorë	253
130	“Sami Frashëri”	Tiranë qytet	Tiranë	1419
131	“P.N.Luarasi”	Tiranë qytet	Tiranë	1291
132	“Qemal Stafa”	Tiranë qytet	Tiranë	1263

133	“Myslym Keta”	Tiranë qytet	Tiranë	1104
134	“A.Z. Çajupi”	Tiranë qytet	Tiranë	1016
135	“Besnik Sykja”	Tiranë qytet	Tiranë	895
136	“Partizani”	Tiranë qytet	Tiranë	849
137	“Asim Vokshi”	Tiranë qytet	Tiranë	786
138	“Aleks Buda”	Tiranë qytet	Tiranë	676
139	“Sinan Tafaj”	Tiranë qytet	Tiranë	621
140	“Arben Broci”	Tiranë qytet	Tiranë	580
141	“Jordan Misja”	Tiranë qytet	Tiranë	564
142	“Eqerem Çabej”	Tiranë qytet	Tiranë	441
143	“Avdulla Keta”	Tiranë qytet	Tiranë	370
144	“Sandër Prosi”	Tiranë qytet	Tiranë	334
145	“Loro Boriçi”	Tiranë qytet	Tiranë	212
146	“Asim Vokshi”	Tropoje	Tropoje	522
147	“Ali Demi”	Vlorë	Vlorë	914
148	“Halim Xhelo”	Vlorë	Vlorë	347
149	“Jani Minga”	Vlorë	Vlorë	274
150	“Mustafa Q. Atatürk”	Vlorë	Vlorë	213

## ***Shtojca 2***

### **DEKLARLITE PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTAVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI**

Unë..... kandidat në procesin e konkurrimit për oficer sigurie në DAR/ZA .....të zhvilluar në vitin shkollor 2018-2019 , autorzohj MASR dhe Ministrinë e Brendshme të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

**AUTORIZUESI**

### **Shtojca 3. Formati i intervistës gjysmë të strukturuar**

#### **Shembuj pyetjesh:**

- *Cili është formimi juaj akademik? Pse e zgjodhët këtë degë? A jeni ndjerë të kënaqur nga zgjedhja juaj? Nëse do t'ju jepej mundësi të rizgjidhnit edhe një herë, do të bënit përsëri të njëjtën zgjedhje?*
- *Cili është roli i Oficerit të Sigurisë në shkollë? Cilat nga detyrat/përgjegjësitë kryesore ju duket e vështirë për tu arritur? Mendoni se ka detyra/përgjegjësi të tjera që mund t'i bëj Oficeri i Sigurisë dhe nuk janë shprehur në përshkrimin e punës? Ju do donit të shtonit të tjera?*
- *A mendoni se jeni ju kandidat potencial për këtë pozicion? Çfarë risie do të sillnit ju në shkollën që do të kryenit detyrën? Cila mendoni se do ishte vështirësia që do të hasnit në ushtrimin e detyrës, duke pasur parasysh kontekstin e zonës?*
- *Cili do të jetë përfitimi i nxënësve nga prezenca juaj në shkollë? Çfarë dini ju për karakteristikat kryesore të tyre që shoqërojnë këtë stad të zhvillimit (adoleshencën)?*
- *Çfarë do të jepni nga vetja në shkollën ku do të punoni? Çfarë mendoni për stafin akademik dhe si mund të bashkëpunoni me ata? Po bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin?*
- *A keni ndonjë mendim tjetër në lidhje me këto çështje? Keni gjë tjetër për të shtuar, apo diçka që ju kujtua tani dhe nuk e keni përmendur më sipër?*